a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaraten e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimi i ofertes, (nese eshte e zbatueshme) sipas Shtojces 3;

b. Deklarate mbi permbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojces 5;

c. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojces 7;

ç .Përshkrimi i Çmimit i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur, sipas Shtojces 1;

d .Formular vleresimi sipas Shtojces 8;

e. Deklarate mbi disponueshmerine e mjeteve sipas Shtojces 9;

f. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë:

- Ofertuesi duhet të tregojë, në objektin e veprimtarisë së tij, se është në gjendje të realizojë objektin e prokurimit.
- Sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” të kësaj shtojce (Shtojca 12).
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i

subjektit, shoqeruar me dokumentacion që vërteton se nuk ka detyrime të pashlyera për taksat vendore pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas ekstraktit të regjistrit, për vitet 2017, 2018 dhe 2019. Vërtetimi duhet detyrimisht të jetë përshkruar, ndër të tjera, edhe NIPT-in e subjektit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Njësiti e Qeverisjes Vendore.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm. Operatori ekonomik duhet nuk duhet të jetë me humbje për të tre vitet e fundit. Për këtë duhet të paraqes kopje të vërtetuar të pasqyrave financiare për periudhën 2017, 2018 dhe 2019, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse të konfirmuar nga ky autoritet me nënshkrim dhe vulë në c'do faqe të dokumentit, të shoqëruar me Raport të Ekspertit Kontabël. Nuk është e detyrueshme paraqitja e Raportit të Ekspertit Kontabël për ato subjekte që nuk plotësojnë kushtet ligjore.
- Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 50% vleres së fondit limit të tenderit. Për këtë të paraqitet Vërtetimi nga organet Tatimore për xhiron vjetore gjatë tre viteve të fundit.

3. Kapaciteti teknik

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

3.1. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet në një vlerë jo më pak se **40%** të fondit limit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, ku zerat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit ne prokurim;

ose

3.2. Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë jo më pak se 200% i fondit limit, ku zerat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit ne prokurim.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bënë ofertën të kualifikueshme.

Si referencë për llogaritjen e afateve do të merret data e kolaudimit të objektit.

Për të vërtetuar pikën **1 ose 2** duhet të paraqitet:

- a-Kontratë/kontratata nënshkruar nga palët.
- b-Situacion i përfundimtar të punimeve.
- c-Aktin e kolaudimit të punimeve.
- d-Aktin e marrjes në dorëzim të punimeve nga investitori.
- e-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës 8.

Për objektet me financime private:

- a.i. Leje ndertimi
- a.ii. Kontratën e Sipërmarrjes,
- a.iii. Situacion përfundimtar të objektit,

Dokumenta Standarde të Tenderit

- a.iv. Aktin e Kolaudimi përfundimar të objektit,
- a.v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse, vlerësuar me notën 10 ose e shprehur në fjalë “shumë mirë”.
- a.vi. Faturen/at tatimore.

Për objektet me vetëfinancim (nga Operatori Ekonomik):

- a.i. Leje ndertimi
- a.ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- a.iii. Aktin e Kolaudimi përfundimar të objektit,
- a.iv. Faturen/at tatimore.

4. Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë:

N.P - 3 A Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash.

Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

5. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë ISO 9001-2015 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rastë bashkimitë OE duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve).
- Certifikatë ISO 14001-2015 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rastë bashkimitë OE duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve).
- Certifikatë OHSAS 18001-2007 ose certifikatën ekuivalente ISO 45001-2018, të njohur nga standartet shqiptare, (E vlefshme me auditim vjetor. Në rastë bashkimitë OE duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve).
- 1 (nje) inxhinier të certifikuar për përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të punësuar si drejtues teknik pranë subjektit ofertues.

Certifikatat të jenë lëshuar në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

6. Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	DISPONIMI	SASIA
	Kamion, mbi 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
	Kamion, nga 7.5 deri 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
	Kamion, nga 3.5 deri ne 7.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
	Kamioncin, deri ne 3.5 ton.	Në pronësi ose me qira	Copë 2
	Kamion, nga 7.5 deri 18 ton, me vinç	Në pronësi ose me qira	Cope 1
	Autobetoniere kantjeri	Në pronësi ose me qira	Cope 1
	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	Cope 1
	Autopompë/Presë betoni	Në pronësi ose me qira	Cope 1
	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Cope 1
	Autofshese	Në pronësi ose me qira	Cope 1
	Mjet me kosh	Në pronësi ose me qira	Cope 1
	Kallëp metalik për betonin	Në pronësi ose me qira	15 M2

Dokumenta Standarde të Tenderit

Pompë suvatimi	Në pronësi ose me qira	Cope 1
Betoniere	Në pronësi ose me qira	Cope 5
Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	Cope 5
Gjenerator	Në pronësi ose me qira	Cope 3
Depozita uji nga 1.000 litra deri 8.000 litra	Në pronësi ose me qira	Cope 3
Kuti e ndihmës së shpejt	Në pronësi ose me qira	Cope 6
Kaskë pune sigurie/kapele minatori	Në pronësi ose me qira	Cope 15
Pelerina shiu	Në pronësi ose me qira	Cope 15
Rrip sigurimi	Në pronësi ose me qira	Cope 15
Jelekë fosforeshent	Në pronësi ose me qira	Cope 15
Kepuce pune	Në pronësi ose me qira	Cope 15
Dorashka pune	Në pronësi ose me qira	Cope 15
Karroca dore	Në pronësi ose me qira	Cope 5
Kominoshe	Në pronësi ose me qira	Cope 15
Tabela sigurie	Në pronësi ose me qira	Cope 5
Prozhektor / ndriçues	Në pronësi ose me qira	Cope 4
Transpalet (pirun)	Në pronësi ose me qira	Cope 1
Fabrikë betoni shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore Kodi: III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit. 20 km nga kantjeri i ndertimit.	Në pronësi, qira ose kontratë noteriale furnizimi.	
Fidan peme. Shoqëruar me çertifikatë fitosanitare, e lëshuar jo më parë se 6 muaj nga data e tenderit.	Prodhues, tregtues ose kontratë furnizimi.	
Materiale llaçra. Shoqëruar me çertifikatë ISO 9001:2015, e vlefshme.	Prodhues, tregtues ose kontratë furnizimi.	

Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë (kontrata e blerjes apo dhurimi, fature çdoganimi, fatura tatimore perkatese, etj). Ato të marra me qera të shoqërohen me aktin e pronësisë së qiradhënësit (kontrata e blerjes apo dhurimi, fature çdoganimi, fatura tatimore perkatese, etj), me kontratë noteriale qiraje (ose formë tjetër huaje) e cila duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plote të punimeve. Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet edhe: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjeteve, çertifikate për transport material dhe foto të mjeteve ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit. Në rastë se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i rregjistruar në një vënd të huaj, atëherë mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me rregjim të përkohshëm, e cila vërtetohet nëpërmjet dokumentit hyrës dhe një deklaratë ku të jetë e shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive.

Ofertuesi duhet të paraqes një deklaratë me shkrim të administratorit të shoqërisë ku deklaron se të gjitha mjetet e sipërcituara nuk janë në angazhim në asnjë objekt tjetër. Deklaratë me shkrim nga administrator i shoqërisë që, A.K rezervon të drejtën të kryejë në cdo kohë verifikimin fizikë të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa paralajmërim paraprak (në rastë verifikimi në fjalë do

Dokumenta Standarde të Tenderit

të hartohet një procesverbal që do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i AK dhe përfaqësuesi i shoqërisë ofertuese). Në këtë deklaratë ofertuesi duhet të bëjë deklarinimin e adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve, me qëllim verifikimin e tyre. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.

7. Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një staf bashkë me punonjës të siguruar mesatar 25 punonjës për periudhën janar 2020 – qeshor 2020. Për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet tatimore dhe listëpagesat të konfirmuara nga administrata tatimore perkatese me nënshkrim dhe vulë. Shkeljet e akteve ligjore apo akteve nënligjore në deklarinimin e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve do të jenë kushtë për skualifikimi. Të gjithë të punësuarit duhet të jenë të deklaruar në listëpagesat e shoqërisë sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës.

8. Subjekti duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier / specialistë:

- Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe të plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë nga muaji Janar 2019 e në vazhdim.

- Drejtues Teknik inxhinier mekanik, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe të plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë nga muaji Janar 2019 e në vazhdim.

- 1 drejtues teknik, të punësuar të operatorit ekonomik, të jenë të certifikuar për ushtrimin e profesionit "Ekspert privat zjarrefikës", për këtë duhet të paraqes certifikatë për ushtrimin e profesionit.

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë dhe punonjesit nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror apo privat pervec subjektit ofertues. Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga të gjithë drejtuesit teknik të shoqërisë dhe administratori i shoqërisë, si dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.

Shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë, nga administratori i shoqërisë, ku të percaktoj drejtuesin/t teknik të shoqërisë/i të cili/ët do të jetë/në i të pranishëm gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt. Gjithashtu në këtë deklaratë administratori i shoqërisë duhet të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë për drejtuesin teknik. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.

9. Mjekë, 1 të punësuar, i cili të jetë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator 2016 e në vazhdim, referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", shoqëruar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licensë. Në rast bashkim operatorësh të paktën njëri duhet ta plotësoj këtë kriter.

10. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise, nga muaji janar 2020 e ne vijim, punonjesit e meposhtem:

- Bojaxhi, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
- Hidrozolues, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.
- Hekurkthyes, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.
- Karpentjer, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
- Manovrator për makineritë e rënda, shoqëruar me: kontratë pune dhe leje manovrimi,
- Mekanik, shoqëruar me: kontratë pune, dëftesë (diplomë)/ çertifikate dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.
- Specialist ndertimi, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.
- Shofer për drejtimin e mjeteve kamiona, shoqëruar me: kontratë pune dhe leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE", minimalisht 2 të punësuar.
- Teknik ndërtimi, shoqëruar me: kontratë pune, dëftesë (diplomë) dhe me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.
- Specialist dyer dritare, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.

11. Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës dhe me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

12. Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzoj analizat teknike për secilin cmim të preventivit të ofertës. Bazuar ne VKM Nr.514, datë 15.8.2007 për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit pika 10.

Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdolloj kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër do të rezultojë në përjashtimin nga procesi i të gjithë ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Operatorët e huaj ekonomik, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), për të gjithë përmbajtjen e dokumentit, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar "Apostille". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventen e Hagës, datë 5 tetor 1961, "për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentëve

Dokumenta Standarde të Tenderit

zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (mosparaqitja në këtë formë është kushtë skualifikues).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 12

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrim i punëve : **Bashkëngjitur**

Grafiku i Punimeve: **Bashkëngjitur**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Bashkëngjitur**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj: **Bashkëngjitur**

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkëngjitur

Shtojca 14.

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 15

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____ | _____ |

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në

Dokumenta Standarde të Tenderit

referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe

Dokumenta Standarde të Tenderit

shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të

Dokumenta Standarde të Tenderit

dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në

Grafikun e realizimit te punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezyrtshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda

afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

